

4.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Njefare progresi mund te raportohet ne fushen e kontrollit te brendshem financiar publik (KBFP).

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik (PFID) eshte ngritur brenda Ministrise se Financave, por ende ka nevojte te pajiset plotesisht. Rekrutimi i inspektoreve buxhetore neper administrata ka perfunduar. Trajnimi eshte ne vazhdim e siper. Kjo duhet te kontribuojte ne ndarjen e auditimit te brendshem dhe te inspektimit dhe sqarimin e rolit te auditimit te brendshem, si mbeshtetje per menaxhimin. Megjithate, ndersa korniza ligjore kryesore per inspektim te buxhetit te centralizuar eshte vendosur , zbatimi i Legjislacionit mbi procedurat per te kryer inspektime financiare eshte ende duke u pergatitur.

Ne lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK), duhen ripare marreveshjet brenda ministrive te linjes per te shmangur konfliktet aktuale ndermjet Ligjit Organik te Buxhetit dhe Vendimit te Qeverise per standardet dhe procedurat per organizimin e brendshem te institucioneve te administrates publike. Trajnimi me i plote rreth implikimeve te futjes se ligjit te MFK eshte i nevojshem. Ne lidhje me auditimin e brendshem, nje Vendimi i Keshillit te Ministrave per kriteret per krijimin e njesive te auditimit te brendshem ne subjektet publike eshte miratuar ne prill te vitit 2012. Njesia Qendrore e Harmonizimit per Auditimin e Brendshem ka filluar te shqyrtojte programin e trajnimit per auditor& e brendshem. Ne pergjithesi, cilesia e auditimeve te brendshme ende ka nevojte te permiresohet.

Ka pasur progres ne fushen e auditimit te jashtem. Nje kryetar i ri i Kontrollit te Larte te Shtetit (KLSH), u emerua nga Parlamenti ne dhjetor 2011. Pas disa viteve ne ngecje, projekt-ndryshimet ne Ligjin per KLSH per te sjelle ate ne perputhje te plote me standardet e Organizates Nderkombetare te Institucioneve Supreme te Auditimit (INTOSAI) jane pergatitur dhe jane dorezuar ne procedure te miratimit.

KLSH i kryen te gjitha llojet kryesore te auditimeve, por auditimet tip inspektimi te rregullise dhe pajtueshmerise ende perbejne shumicen e auditimeve te tij (rreth 90% ne 2011).

Trajnimi i audituesve te KLSH gjate vitit 2011 ka gene i kufizuar. Ndersa ka deshmi te pranimit me te madh te rekomandimeve te KLSH-se nga ana e subjekteve te audituara, efikasiteti i ndjekjes parlamentare te raporteve te auditimit te KLSH-se duhet permiresuar.

Ka pasur pak progres ne mbrojtjen e interesave financiare te BE-se. Rekrutimi i personelit per PFID, e cila sherben si nje pike kontakti per Komisionin European dhe

Zyren e tij te Anti-mashtimit (OLAF), është në vazhdim e sipër. Megjithatë, kapacitetet administrative në këtë fushë duhet të ndërtohet. Pak progres mund të raportohet lidhur me mbrojtjen e euros kundër falsifikimit. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në mënyrë aktive në programin e Perikliut. Pas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për të krijuar Qendrën Kombëtare të Analizave, një ekspert në shqyrtimin dhe hetimin e kartëmonedhave të falsifikuara ishte rekrutuar në shkurt 2012. Konkluzionet Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e kontrollit financiar. Përpjekje të konsiderueshme janë ende të nevojshme për të adresuar mangësitë ekzistuese në zbatimin e kuadrit ligjor të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar, futjen e parimit të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe sjelljen në nivel të auditimit të jashtëm në standardet e INTOSAI. Në përgjithësi, përgatitjet ende nuk kanë avancuar shumë.

Ka pasur pak progres ne mbrojtjen e interesave financiare te BE-se. Rekrutimi i personelit per PFID, e cila sherben si nje pike kontakti per Komisionin European dhe Zyren e tij te Anti-